



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9 Korrik 2023

Nr: 687

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE REGJISTRUAR ME NR. 405 ID, 410 ID, 412 ID, 413 ID
DHE 414 ID PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Data: 9 Korrik 2023

Nr: 687

Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 405 ID, 410 ID, 412 ID, 413 ID dhe 414 ID”

- Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 9.5.2023, është administruar shkresa nga z. Ivi Kaso, regjistruar me nr. 405 ID, me lëndë *“Publikim sondazhi”*, me objekt denoncimi *“Media Report TV, ka organizuar publikimin e sondazheve sipas institutit italian Piepoli.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 9.5.2023, është administruar shkresa me nr. 4866 prot., nga z. Ivi Kaso, regjistruar me nr. 410 ID, me lëndë *“Përdorim i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Disa javë para zgjedhjeve vendore 14 majit, kandidati i PS për Bashkinë Kamëz njofton rrjetin e tij FB si më poshtë: Promovim i punimeve të kryera në rrugën Harku i Triumfit, bashkë me Kryetaren e Kuvendit Lindita Nikolla. Promovimi i projektit për rikualifikimin e zonës për rindërtimin në Valias. Promovimi i punimeve për ndriçimin e rrugëve "Azem Hajdari" , "Bubullimë", "Librazhd", "New York" dhe "Besim Cera". Promovim i përfundimit të punimeve në urën që lidh Laknasin me Valiasin. Promovimi i punimeve në ndërtimin e KUN-së në Frutikulturë. Promovimi i punimeve për rikualifikim urban të zonës në Valias. Promovimi i përfundimit të punimeve në rrugën Luzi i Vogel. Promovimi i përfundimit të punimeve për qëndrën shëndetësore Zall-Mner. Promovimi i punimeve në rrugët Nato, "Pashko Vasa", "Josef Marksen", "Isa Boletini" dhe "Haki Taho". Takim me biznesin bashkë me Kryetaren e Kuvendit Lindita Nikollia.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 9.5.2023, është administruar shkresa me nr. 4585 prot., nga Qendra “Qëndresa Qytetare”, regjistruar me nr. 412 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Më datë 5 Maj 2023, në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare "Sali Hajdari" në fshatin Helshan, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Hasit, z. Beqir Mulaj dhe banorëve të këtij fshati. Kandidatin e ka shoqëruar postimin e këtij takimi me pershkrimin: "Duam punë, jo fjalë. Veprat janë ato që na duhen për të zhvilluar bujqësinë, blegtorinë dhe për të ndërtuar infrastrukturën rrugore, e cila na favorizon për daljen në treg të prodhimeve tona. Kjo ishte kërkesa që mu artikulua këtë të mërkurë teksa realizuam takime me banorët e Kosturrit, Helshanit dhe Perollajvë. Demagogjia nuk ka vend te ne, pasi ne duam njëriun e punës, jo të mendojë për të hollat e veta, theksuan më tej banorët e këtyre tri fshatrave, të cilët konstatova se me 14 Maj do të votojnë për të ecur përpara dhe jo mbrapa. Shumë i lumtur qe ata kishin diskutuar edhe përpara programin tonë, pasi e konsiderojnë si të duhurin për Hasin me perspektivë për çdo fëmijë, të ri apo të re, prind, të moshuar, fermer, blegtor, biznes i vogël apo edhe qytetar i thjeshtë! Mirënjohës pafund që mora mbështetjen e tyre, fjalë së cilës më 14 Maj fitorja është e sigurtë!”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 9.5.2023, është administruar shkresa me nr. 4859 prot., nga Qendra “Qëndresa Qytetare”, regjistruar me nr. 413 ID, me lëndë *“Përdorim i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Më datë 3 Maj 2023, në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, është zhvilluar një takim mes kandidatit të*

Partisë Socialiste për Bashkinë e Malesisë së Madhe, njëherazi dhe kryetar i kësaj bashkie, z. Tonin Marinaj dhe banorëve të fshatit. Siç rezulton edhe nga pamjet filmike, z. Marinaj e ka zhvilluar këtë aktivitet në ambientet e shkollës.”

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 9.5.2023, është administruar shkresa me nr. 4865 prot., nga z. Ivi Kaso, regjistruar me nr. 414 ID, me lëndë “Përdorim i burimeve publike”, me objekt denoncimi “Në datën 26.04.2023 Kryetari i Bashkisë Kolonjë z. Erion Isaj, i ka propozuar Këshillit Bashkiak miratimin e Projekt-Vendimeve nr. 54,55,63 për dhënin e sipërfaqeve për përdorim në fshatin Rehovë, fshatin Qinam, fshatin Tac-Agalli, fshatin Selenicë dhe Qendër Novoselë, me qëllimin e ndërtimit të një parku fotovoltai dhe zhvillimin e një impianti për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga dielli dhe era.”

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjeve objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve nr. 405 ID, 410 ID, 412 ID, 413 ID dhe 414 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI